

(lingua albanese/kosovo)



PROKURORIA E REPUBBLIKÈS ***PRANE ĜJYKA TÈS SÉ MODENA***

Nè nenin 90 bis. k.p.p ligji i njeh të drejtat si? vijoje

PERSONIT TÈ DÈMTUAR NGA VEPRA PENALE

A) Për ushtrimin e të drejtave të tij të caktuara nga ligji sipas nenit 101 k.p.p, mund të emërojë një avokat mbrojtës në format si më pas:

a) me deklaratë të paraqitur të njëjtit autoritet pro?edues;

b) me deklaratë të dorëzuar autoritetit pro?edues nga avokati mbrojtës ose të dërguar, me rekomandë;

Mbrojtësi ka të drejtë të kryej hetime për mbrojtjen e personit si? parashikohet nga neni 391 bis dhe vijuesit e tij k.p.p, dhe, sipas nenit 33 dispozitat e k.p.p.. “vendbanimi ipersonit të dëmtuar nga vepra penale që ka emëruar një mbrojtës quhet i emëruar pranë ketij të fundit”.

Mund të prezantojë denoncim ose padi (që përmban elementët kryesor të faktit që kërkon të denoncojë) sipas formave të parashikuara nga neni 337 k.p.p, gojarisht ose me shkrim pranë ?do: stacioni të Karabinierëve, zyrë të Policisë të Shtetit, zyrë të Policisë Financiare, zyrë të Policisë Lokale, dhe pranë Prokurorisë së Republikës, si dhe pranë ?do zyre tjetër të policisë gjyqësore, edhe nëpërmjet një Përfaqësuesi të Konsullatës jashtë Shtetit.

Denoncimi mund të prezantohet personalisht ose nëpërmjet një prokurori të posa?ëm, nëse është paraqitur me shkrim duhet të jetë i nënshkruar nga vetë denoncuesi ose nga një prokuror i posa?ëm i tij; në këto rrethana prokura duhet të jetë e lëshuar për akt publik o shkrim privat origjinal, që duhet të tregojë objektin për të cilin jepet dhe faktet për të cilat bëhet fjalë dhe që duhet të jetë e bashkëngjitur me denoncimin;

Informohet që për vepra penale të caktuara të parashikuara nga ligji, procedimi mund të ketë vazhdim vetëm nëse është padia e personit të dëmtuar dhe kërkesa për dënimin e autorit të faktit të denoncuar.

Mund të prezantojë padi edhe i mituri që ka mbushur 14 vje?.

Në ve?anti mund të pro?edohet me padi për veprat penale: dëmtim me dashje (përve? rasteve më të rënda të parashikuara nga ligji), akte persekutues dhe dhunë seksuale.

Afatet për prezantimin e padisë (përve? mos pranimit ose heqjes dorë të shpallur o të nënkuptuar) dhe në mënyrë të përgjithshme tre muaj nga dita e njoftimit të faktit, dhe padia mund të tërhiqet përpara dënimit të subjektit i vlerësuar si përgjegjës i faktit.

a) Dhunë seksuale (përve? rastit kur vepra penale është e rënduar o e kryer në dëm të të miturit që ka më pak se 18 vje?, dhe nuk është e lejuar tërheqja;

b) Aktet persekutues (përve? rasteve kur kryhen në drejtim të të miturve ose të personave me të meta fizike, ose kur lidhen me krim tjetër i pro?eduar nga ligji) dhe tërheqja lejohet vetem nëpërmjet “gjqit”;

Padia është e përvokueshme në qoftë se aktet persekutues janë kryer nëpërmjet “kërcënime të rënda dhe të vazhdueshme” ose të kryera “me armë, o nga person i paraqitur ndryshe, o nga shumë persona të bashkuar, o me shkrime anonime, o në mënyrë simbolike, o duke përdorur forcë kërcënuese me prejardhje nga shoqata sekrete, ekzistuese o supozuese” (neni 612 paragrafi 2 dhe neni 339 k.p).

Nga e drejta për të paraqitur padi mund të hiqet dorë, në mënyrë të shprehur ose të heshtur; i mituri që ka mbushur 14 vje? mund të paraqesë padi edhe në rastin kur prindëri ose kujdestari kanë hequr dorë.

Personi i dëmtuar gjatë zhvillimit të hetimeve dhe të pro?esit mund të ushtrojë të drejtat e tij si? parashikohen nga ligji (neni 90 k.p.p) në ?do gjëndje dhe shkallë të pro?edimit, mund të prezantojë shkresa, dhe të tregojë elementë të provës (përve? rasteve të gjykimeve në Kasacion); ka dhe të drejtë të vihet në dijeni për datën, për vëndin e procesit dhe akuzën, dhe nëse bën pjesë në palën civile ka të drejtë të marrë njoftimin e sentencës, edhe me ekstrakt; ka të drejtë të marrë pjesë në seanca;

B) Personi i dëmtuar ka edhe të drejtë të marrë njoftime për gjëndjen e procedimit, regjistrimeve (për tipin e veprës penale të regjistruar dhe të personit të cilit i është ngarkuar) si? është parashikuar nga neni 335, paragrafi 1 e 2 k.p.p. duke prezantuar kërkesë të posa?me, personalisht ose nëpërmjet avokatit mbrojtës të emëruar, pranë Prokurorisë të Republikës kompetente; Mbasi kanë kaluar 6 muaj nga data e paraqitjes së denoncimit, ose të padisë, personi i dëmtuar nga vepra penale, mund të kërkojë informacione nga Autoriteti që ka në ngarkim pro?edimin, në lidhje me gjëndjen e tij;

C) Me vëmëndjen e Prokurorit të Ministrisë do të njoftohet për kërkesën e arkivimit të pro?edimit, në rastin kur vepra penale është kryer me ⁴⁴ dhunë drejt personit”, në këtë rast, brënda 30 ditë ve nga njoftimi, mund të shqyrtojë aktet dhe të prezantojë kundërshtim me kërkesë të motivuar për vazhdimin e hetimeve paraprake;

Për të gjitha rastet e tjera do të njoftohet për kërkesën e arkivimit të pro?edimit, me kusht që në denoncim, në padinë, ose më pas, ka deklaruar hapur të jetë i informuar rreth ?do eventuale kërkesë të arkivimit, dhe afati për të prezantuar kundërshtim është prej 20 ditësh.

Z>)Personi i dëmtuar ka të drejtë të përfitojë konsultim ligjor dhe ndihmë juridike me shpenzimet e Shtetit, sipas dispozitave në fuqi dhe në mënyrë të ve?antë:

- “Mund të përfitojë ndihmë ligjore kush është titullar i të ardhurave mbi tatim rezultuese nga deklarata e fundit jo me shumë se € 11.369,24 (limiti në fuqi në 2014 dhe i përshtatur ?do dy vjet).

Përve? si? parashikohet nga neni 92 (limiti i të ardhurave shtohet me € 1032,91 për ?do familjar bashkëjetues), nëse personi i interesuar bashkëjeton me bashkëshorten ose me persona të tjerë të familjes, të ardhurat përbëhen nga shuma e të ardhurave të marra në të njëjtën periudhë nga ?do pjesëtar i familjes, së bashku me personin në fjalë.

Për të përcaktuar limitin e të ardhurave merren parasysh edhe të ardhurat që sipas ligjit janë të përjashtuara nga tatimet mbi të ardhurat e personave fisikë (IRPEF) o që janë subjekt të tatimeve zëvendësuese.

Merren parasysh vetëm të ardhurat personale kur janë objekt të qështjeve për të drejtat e personit si dhe në proqeset në të cilët interesat e kërkuessit janë në konflikt me ato të pjesëtarëve të tjerë të përbërjes familiare bashkëjetues me të.”

Mund të përfitojë ndihmë ligjore edhe në rast përjashtimi nga limitet e të ardhurave — lart përmëndur-
:

”1) Personi i dëmtuar nga veprat penale sipas parashikimit të nenit: a) 572 (keqëtrajtim kundër familjarëve edhe bashkëjetues ve); b) 583 bis (gjymtim i organeve gjenitale; c) 612 bis (akte persekutues); d) 609-bis (dhunë seksuale); e) 609-quater (Akte seksuale me të mitur); f) 609-octies (dhunë seksuale në grup);

2) I mituri, personi i dëmtuar nga veprat penale sipas parashikimit të nenit: a) 600 (reduktim dhe mbajtje në skllavëri); b) 600-bis (prostitucion i të miturve);

c) 600-ter (pornografi e të miturve); d)600-quinquies (Iniciativa turistike për shfrytëzim të prostitucionit të të miturve); e) 601 (trafik personash); f) 602 (Shitje dhe blerje të shkllëvërve; g) 609-quinquies (korrupsion i të miturve); h) 609-undecies (rekrutim i të miturve)”.

Kërkesa për praninë të ndihmës ligjore me shpenzimet e Shtetit, për të qënë e pranueshme duhet të jetë e nënshkruar nga i interesuari dhe e vërtetuar nga mbrojtësi me format e parashikuara nga DPR n.445/2000;

Kërkesa, më letër të thjeshtë, për të qënë e pranueshme duhet të përmbajë dispozitat e caktuara në nenin 79 del DPR n.1 15/2002;

E) Në rastin kur nuk njeh gjuhën italiane personi ka të drejtën e përkthimit të akte ve me mënyrat vijuese:

- Se dëshëron, ose duhet të bëjë një deklaratë në gjuhë të huaj, edhe me shkrim, emërohet një përkthyes dhe deklarata përkthehet;

- Nëse do të marrë pjesë në seancë dhe bën kërkesë do të ndihmohet nga një përkthyes ;

- Ka të drejtën e përkthimit falas të akteve, ose të një pjese të tyre, që përmbajnë informacione të vlefshme për ushtrimin e të drejtave të tij;

- Nëse paraqet denoncim ose padi pranë Prokurorisë së Republikës pranë Gjykatës së rrethit (në krahinën e Lazio, Prokuroria e Republikës është ajo pranë Gjykatës së Romës), ka të drejtë të përdorë gjuhën nga ai e njojtur. Në të njëjtat raste ka të drejtë të përfitojë, nëpërmjet kërkesës, përkthimin në një gjuhë nga personi i njojtur të vërtetimit të denoncimit ose të padisë.

F) Janë parashikuar masa mbrojtje për personin e dëmtuar nga vepra penale të caktuara.

Në veçanti, nëse autori i fakteve të denoncuara është një i afërm ose një bashkëjetues, viktima ka të drejtë të kërkojë për tutelën e saj që të zbatohet në drejtim të autorit të faktit, masa parandaluese, e “*largimit nga shtëpia familjare*” (neni. 282 bis k.p.p.), dhe ndalimin e afrimit në vëndet të caktuara të frekuentuara zakonisht nga personi, ose masa e “*ndalim afrimi në vëndet të frekuentuara nga personi i dëmtuar*” (neni. 282 ter k.p.p.).

Personi i dëmtuar ka të drejtë të marrë në përputhje me nenin 282 quater paragrafi 1 k.p.p. njoftime mbi aplikimin e masave parandaluese të “*largimit nga shtëpia familjare*” dhe “*ndalimin e afrimit në vëndet e frekuentuara nga ai vetë dhe nga të afërmit e tij*”, në drejtim të autorit të veprës penale dhe mund të kërkojë të mos rezultojë vëndi ku banon zakonisht në aktet në njoftim të të pandehurit.

Kur bëhet kërkesë (përveç rasteve kur rezulton rrezik konkret të një dëmi për autorin e veprës penale) në procedimet në ngarkim të autorit për fakte të denoncuara në dëm të tij, në rastet e veprave penale të kryera me “*dhunë ndaj personit*” ka të drejtë të marrë njoftime të menjëhershme të masave të:

1. “*arratisje*” e të burgosurit me mbikqyrje në burg, ose në shlyerje të dënimit të caktuar;
2. “*zhburgosje*”, për ndërprerjen e shlyerjes së dënimit të caktuar;
3. Ndërprerje të një mase të sigurisë të caktuar (REMS dhe Shtëpi kurimi dhe mbikqyerje).

Personi i dëmtuar i huaj, viktimë e shfrytëzimit të prostitucionit, o të veprave penale për të cilat parashikohet arrestimi i detyrueshëm në flagrancë (neni 380 k.p.p) që gjëndet në situatë dhune o shfrytëzimi të rëndë, mund të kërkojë “*qëndrim për qëllim mbrojtje sociale*”, në bazë të kushteve të parashikuara nga neni 18 bis D.L.vo 286/1998;

Nëse deklaron të qëndrojë o të banojë në Itali, dhe manifeston ose shpreh qëllimin që të qëndrojë në një Shtet tjetër të Komunitetit Europian, në procedimet në të cilat rezulton si “*person nën mbrojtje*” dhe në ngarkim të autorit të sjelljeve të dhunës në dëm të tij, është shpallur masa parandaluese e largimit nga shtëpia familjare (neni. 282 bis k.p.p.) ose ndalim afrimi në vëndet e frekuentuara zakonisht nga personi i dëmtuar (neni 282 ter k.p.p.), ka të drejtë të kërkojë gjykatësit që ka zbatuar këtë masë të emetojë urdhërin e “*urdhër për mbrojtje europiane*”.

Kërkesa mund të paraqitet edhe nga përfaqësuesi ligjor i personit nën mbrojtje. Në kërkesë, për tu pranuar, duhet të tregohet vëndi në të cilin personi nën mbrojtje ka zgjedhur të qëndrojë, kohëzgjatja dhe arsytet e qëndrimit.

G) Në rastin kur qëndron në një Shtet anëtar të Bashkimit Europian tjetër nga ai në të cilin është kryer vepra penale, denoncimet dhe paditë do të dërgohen nga Prokurori i Republikës drejt Prokurorit të përgjithshëm pranë Gjykatës të Apelit më qëllim që t'ua dërgojë Autoriteteve gjyqësore kompetente. Përveç kësaj kur paraqiten kushtet, mund të kërkojë emetimin e “ urdhërit për mbrojtje europiane”, si? tregohet në pikën e mësipërme;

H) Në rast të shkeljes të të drejtave të tij mund të paraqes shkrime e denoncime pranë autoriteteve gjyqësore që pro?edojnë, pranë të gjitha zyrave të policisë gjyqësore duke paraqitur faktet që kanë shkelur të drejtat e tij;

I) Mund të kërkojë informacione mbi pro?edimet në të cilat është person i dëmtuar, edhe nëpërmjet mbrojtësit të emëruar, duke ju drejtuar, në fazën e hetimeve paraprake zyrave kompetente të Prokurorisë së Republikës dhe në vazhdim zyrave kompetente të gjykatës, duke paraqitur lutje me shkrim dhe kërkesa në kan?elarinë e gjykatësit që pro?edon;

L) Personave të dëmtuar që duhet të japin deklaratat pranë Prokurorit të Ministrisë, ose me autorizimin e të të njëjtit, të policisë gjyqësore, dhe që nuk janë banues në vendin kur janë njoftuar për tu paraqitur, kanë të drejtë për pagesën e shpenzimeve për udhëtimin, për vajtje dhe ardhje, me vlerën e biletës të klasës së dytë në shërbimet e linjës ose ?mimin e biletës të avionit të klasës ekonomike, nëse janë autorizuar më parë nga autoritete gjyqësore.

Nëse këto shërbime nuk ekzistojnë, pagesa e shpenzimeve të udhëtimit i referohet lokalitetit më të afërm ku ekziston shërbimi i linjës.

Përdorimi i taksisë pagohet vetëm në rastin kur është autorizuar përpara.

Ka të drejtë gjithashtu për pagesën e 0,72 euro për ?do ditë të përdorur për udhëtimin, dhe pagesën e 1,29 euro për ?do ditë të qëndrimit në vendin e ?ështëjes.

Kjo e fundit i përket vetëm rastit kur dëshmitarët janë të detyruar të qëndrojnë jashtë banimit të tyre të paktën një ditë të tërë përveç asaj të nisjes e të kthimit.

Të ngjashme janë dispozitat për personat e dëmtuar që janë njoftuar si dëshmitarë pranë Gjykatësit.

Kërkesa për autorizimin dhe shlyerja e pagesës e dokumentuar (edhe me dorëzimin e biletave origjinale), duhet ti dorëzohet autoritetit gjyqësor që ka kërkuar paraqitjen.

M) Është e mundur të kërkohet dëmshpërblim i dëmit të shkaktuar nga vepra penale sipas nenit 185 k.p. që parashikon “ ?do vepër penale detyron kthimin, në përputhje me ligjet civile” dhe që, “në rastin kur ka shkaktuar një dëm pronësor ose jo pronësor, detyron të japë shpërblim fajtor dhe personat e tjerë që përgjigjen në emër të tij”.

Dëmshpërblimi mund të kërkohet duke marrë pjesë si palë civile në procesin penai, ose duke kryer veprime civile pranë Gjykatës kompetente ose pranë Gjykatësit të Paqes.

Të dyja rastet mund të kryhen nëpërmjet emërimit të një mbrojtësi.

N) Në rastin kur është person i dëmtuar nga vepra penale, për të cilën ka të drejtë të ngrejë padi, dhe e ka paraqitur në kohë dhe në mënyrë të vlefshme padinë, procedimi mund të përfundohet me tërheqje të padisë sipas formave dhe kushteve të parashikuara nga neni 152 dhe pasuesit e kodit penal, para dhënies të dënimit të personit fajtor, përveç rasteve kur ligji vendos ndryshe;

Në rast tërheqja e padisë për të patur efekt shuarje, duhet të pranohet në mënyrë të hapur ose të nënkuptuar, nga personi që akuzohet me padi;

Mëgjithatë, është e përvokueshme padia për krime të kryera me dhunë seksuale, dhe ajo për krime persekutues nëse kryhen nëpërmjet “kërcënime të persëritura” të rënda o të kryera “me armë, o nga person i paraqitur ndryshe, o nga shumë persona të bashkuar, o me shkrime anonime, o në mënyrë simbolike, o duke përdorur forcë kërcënuese me prejardhje nga shoqata sekrete ekzistuese o supozuese” (neni 612 paragrafi 2 dhe neni 339 k.p).

Në rast se, për veprën penale mund të kryhet një padi që hyn në kompetencat e Gjykatës të Paqes, procedimi mund të përfundohet me nxitjen e gjykatës në favor të pajtimit ndërmjet palëve dhe tërheqjen e padisë, edhe nëpërmjet aktiviteteve të ndërmjetshme të qendrave dhe strukturave publike të pranishme në territor;

O) Në procedimet kur i pandehuri formulon kërkesën e pezullimit të procedimit me vënien në provë me rrjedhim të shuarjes të veprës penale, në rast të rezultatit të mirë të provës, ka të drejtë të njoftohet dhe të ndërhyjë duke paraqitur shkrime;

Në të njëjtën mënyrë, ka të drejtë të njoftohet dhe të ndërhyjë duke paraqitur shkrime

në rastet kur, vepra penale mund të jetë e përjashtuar nga dënimi për fakte me pak rëndësi, Prokurori i Ministrisë mund të bëjë kërkesën e arkivimit.

P) Në rrethin kompetent të Prokurorisë së Modena, janë të pranishme struktura sanitare, shtëpi familje, qendra kundër dhunës dhe shtëpi për strehim, lista e të cilave dhe adresat e tyre mund të konsultohen në faqet e internetit të institucioneve;

Në veçanti vihet në dukje që:

- 1) Për informacione për viktimat e dhunës dhe akteve persekutive, mund të vihen në kontakt me numërin telefonik (h 24) **1522** të Departamentit për të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta;
- 2) Në faqen www.pariopportunita.gov.it/ janë të treguar edhe numëra të tjerë telefonik të vlefshëm për tu vënë në kontakt: “kundër diskriminimit”, “kundër trafikimit”, dhe “kundër gjymtimeve të organeve gjenerative femërore”;
- 3) Për informacione më të hollësishme mbi strukturat sanitare mund të konsultohet faqja e Ministrisë së Shëndetit: www.salute.gov.it/.

Për informacione të mëtejshme dhe lajme, personi i dëmtuar mund të konsultojë faqjen internet të Prokurorisë të Republikës së Modena brenda të cilës ndodhet një seksion i dedikuar lajmeve të dobishme për personin e dëmtuar nga vepra penale.